



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Ligji Nr. 03/L-067

PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në bazë të nenit 65(1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

Me qëllim të nxjerrjes të legjislacionit mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit i cili është në përputhje me Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës;

Duke pasur parasysh se rindërtimi dhe zhvillimi ekonomik i Kosovës si dhe mirëqenia e qytetarëve të saj është më rëndësi jetike dhe kërkon administrimin dhe privatizimin ose likuidimin me kohë të ndërmarrjeve në pronësi shoqërore;

Duke pasur parasysh se ndërmarrjet dhe asetet të cilat kanë qenë në pronësi shoqërore më ose para datës 31 Dhjetor 1988 munden të jenë subjekte të pretendimeve konfliktuoze pronësore, duke përfshirë pretendimet pronësore private dhe shoqërore; po ashtu duke kuptuar se konstatimi i vlefshmërisë së këtyre pretendimeve, për shkak të kompleksitetit si të provave ashtu edhe të normave të zbatueshme historike ligjore, kërkon një masë të konsiderueshme të kohës dhe punës profesionale;

Duke pasur parasysh se pasiguria e vazhdueshme juridike lidhur me pronësinë e këtyre ndërmarrjeve dhe asetëve është duke i penguar në masë të madhe investimet dhe funksionimin e këtyre ndërmarrjeve dhe asetëve; po ashtu duke kuptuar se kjo pasiguri juridike është duke ndikuar në mënyrë serioze dhe negative në situatën e përgjithshme ekonomike dhe sociale në Kosovë, duke përfshirë, ndër tjera, rritjen e shkallës së papunësisë; uljen e prodhimit vendor; rritjen bilancit negativ tregtar të Kosovës; kufizimin e të ardhurave tatimore publike dhe fiskale; pengimin e aftësisë së Kosovës për financimin e projekteve dhe programeve kyçe publike, duke përfshirë skemat e asistencës sociale, si dhe rritjen e kërkesës mbi këto skema;

I vendosur për zgjidhjen e shpejtë të ndikimeve negative ekonomike dhe sociale të cilat janë shfaqur si rezultat i kësaj pasigurie juridike si dhe për nxitjen e investimeve në këto ndërmarrje dhe asete përmes themelimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe delegimin në këtë Agjenci të autorizimeve të gjëra publike administrative mbi këto ndërmarrje dhe asete, duke përfshirë, por pa u kufizuar, mandatin dhe autoritetin për shitjen ose bartjen e këtyre ndërmarrjeve dhe/ose asetëve në investitorë privatë, ose likuidimin e tyre përmes një procesi të hapur, transparent, konkurrues dhe pa vonesa.

Gjithashtu i vendosur për të siguruar që çdo personi i cili pretendon se ka një interes ose të drejtë të pronësisë ose të kreditorit ndaj ose kundër një ndërmarrje ose aset, t'i epet (i) e drejta për dëgjimin dhe përcaktimin e vlefshmërisë së pretendimit të tij, dhe (ii) nëse ankesa konstatohet e vlefshme, të ketë të drejtën e kompensimit për humbjen ose shkeljen e të drejtave ose interesave të tij; dhe

I vetëdijshëm se administrimi i ndërmarrjeve në pronësi publike do të rregullohet me ligj të veçantë,

Miraton këtë

LIGJ PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

KREU I

Statusi ligjor, qëllimet dhe përkufizimet

Neni 1

Themelimi dhe statusi ligjor i Agjencisë Kosovare të Privatizimit

Agjencia Kosovare e Privatizimit (më tej “Agjencia”) themelohet si një organ i pavarur publik i cili i ushtron funksionet dhe përgjegjësitë në mënyrë plotësisht të pavarur. Agjencia ka zotësi të plotë juridike, posaçërisht për të bërë kontrata, për të marrë, mbajtur ose shitur pronën, si dhe ka të gjitha kompetencat e vetëkuptueshme për përmbushjen në tërësi të detyrave dhe kompetencave të dhëna me këtë ligj; si dhe të padisë e të paditet në emër të saj. Agjencia themelohet si pasardhëse e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit të rregulluar në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12 “Mbi Themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit”, me ndryshime, dhe të gjitha asetet dhe përgjegjësitë e saj do të jenë asete dhe përgjegjësi të Agjencisë.

Neni 2

Synimi dhe qëllimet

2.1 Në pajtim me kushtet e përcaktuara në këtë ligj, Agjencia është e autorizuar për administrimin – duke përfshirë autorizimin për shitjen, transferimin dhe/ose likuidikimin – e ndërmarrjeve dhe aseteve të përkufizuara në këtë ligj.

2.2 Për realizimin e këtij synimi, Agjencia:

a) në pritje të shitjes ose disponimit tjetër sipas këtij ligji, mban dhe administron ndërmarrjet dhe asetet në mirëbesim dhe në të mirë të pronarëve dhe kreditorëve të tyre, në përputhje me këtë ligj dhe Ligjin në Fuqi;

b) shet, transferon ose likuidon ndërmarrjet dhe asetet në përputhje me nenet 6, 8 dhe 9 të këtij ligji, pa vonesa të panevojshme;

c) në bazë të kufizimeve të burimeve të veta administrative, ushtron aktivitete të arsyeshme ndihmëse për ruajtjen ose rritjen e vlerës, shanseve për sukses dhe qeverisjes së ndërmarrjeve dhe aseteve, deri në masën sa këto aktivitete nuk e pengojnë ushtrimin e detyrave të përcaktuara në pikën b) më sipër;

d) në bazë të këtij ligji, përmbush pretendimet e vlefshme dhe të dorëzuara me kohë të Kreditorëve dhe Pronarëve nga mjetet e realizuara nga administrimi, shitja, transferimi ose likuidimi i ndërmarrjes dhe/ose asetit; me ç'rastë të gjitha këto mjete do të mbahen në mirëbesim për pronarët dhe kreditorët dhe do të ruhen nga Agjencia;

e) pas përmbushjes së të gjitha pretendimeve Pronarëve dhe Kreditorëve të dorëzuara me kohë dhe të konstatuara si të vlefshme si dhe pas skadimit të afateve përkatëse kohorë për dorëzimin e këtyre pretendimeve, bartjen e të gjitha fondeve të mbetura të cilat mbahen në mirëbesim nga Agjencia në Qeverinë e Kosovës;

f) kryen detyra të tjera të cilat i janë dhënë sipas Ligjit në Fuqi.

2.3 Agjencia do të veprojë në përputhje me parimet e parashtruara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Protokollet e saj.

Neni 3 Përkufizimet

3.1 Me qëllim të interpretimit dhe zbatimit të këtij ligji, termet dhe shprehjet në vijim - kurdo që përdoren në këtë ligj - kanë kuptimin e përcaktuar më poshtë, përveç nëse konteksti në të cilin këto terme ose shprehje përdoren, qartësisht ka kuptim tjetër:

“Agjenci” do të thotë Agjencia Kosovare e Privatizimit.

“Ligji në fuqi” do të thotë (i) Ligji në Fuqi në Kosovë të përcaktuar në Rregulloren e UNMIK-ut Nr.1999/24 të datës 2 dhjetor 1999, me ndryshime, mbi “Ligjin në Fuqi” në Kosovë; dhe (ii) ligjet dhe aktet nënligjore të shpallura ose të nxjerra në mënyrë të ligjshme nga një autoritet publik i Republikës së Kosovës.

“Aset” do të thotë një aset ose pjesë e vogël mbi të cilin Agjencia ushtron autoritetin në përputhje me nenet 5.1 (a)(ii) dhe 5.1 (a)(iii) të këtij ligji.

“Bord” do të thotë Bordi i Drejtorëve të Agjencisë.

“Rregullore” do të thotë rregulloret e Agjencisë të përkufizuara në nenin 14.1 të këtij ligji.

“Korporatë” do të thotë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar ose shoqëri aksionare të regjistruar në Kosovë dhe të përcaktuar si të tillë sipas Rregullores për Shoqëritë Tregtare.

“Kreditor” do të thotë personi ose subjekti i cili ka një pretendim të vlefshëm si kreditor ndaj një Ndërmarrje dhe/ose një Aseti.

“Drejtor” do të thotë një anëtar të Bordit.

“Drejtor i Sekretarisë Ekzekutive” do të thotë Drejtorin e Sekretarisë Ekzekutive.

“Ndërmarrje” do të thotë ndërmarrje mbi të cilën Agjencia ushtron autoritetin në përputhje me nenin 5.1 (a)(i) të këtij ligji.

“Sekretaria Ekzekutive” do të thotë sekretarinë ekzekutive të Bordit të themeluar sipas nenit 11.5 të këtij ligji.

“RFJ dhe RSFJ” do të thotë, respektivisht, Ish Republikën Federale të Jugosllavisë dhe Ish Republikën Socialiste Federale të Jugosllavisë.

“Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar” do të thotë autoritetin përgjegjës të përcaktuar në Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës së datës 26 Mars 2007 dhe në aktet e tjera përkatës, që, ndër tjera, të mbikëqyrë zbatimin e këtij Propozimi Gjithëpërfshirës.

“Ligji mbi Ndërmarrjet” do të thotë ligji mbi ndërmarrjet i RSFJ (77/88), i ndryshuar me ligjet e RSFJ-së Nr. 40/89, 46/90 dhe 61/90.

“Menaxhmenti” do të thotë Drejtorin Menaxhues dhe Zëvendës Drejtorët Menaxhues të Agjencisë, kolektivisht dhe individualisht.

“Pjesë e vogël” do të thotë një pjesë prej 50 përqind ose më pak që është përkufizuar sipas Ligjit në Fuqi si pronë shoqërore në cilindo person juridik i cili përndryshe është në pronësi private.

“Pronar” do të thotë personi ose subjekti i cili ka një pretendim të vlefshëm në një të drejtë ose interes pronësor në një ndërmarrje ose aset.

“Të ardhurat” do të thotë të ardhurat nga shitja, transferimi ose likuidimi i një ndërmarrje ose aseti sipas Neneve 6, 8 ose 9 të këtij ligji, shuma neto e cilësdo pagesë e cila duhet të bëhet sipas Nenit 10 të Rregullores mbi Transformimin e Pronës së Patundshme.

“Ndërmarrje në Pronësi Publike” do të thotë një ndërmarrje e cila (i) është krijuar si ndërmarrje publike, në pronësi publike ose në pronësi shtetërore sipas Ligjit mbi Ndërmarrjet ose (ii) është themeluar ose për përkufizuar si ndërmarrje në pronësi publike nga nje element i Ligjit në Fuqi të miratuar me apo para 10 Qershorit 1999, pavarësisht nëse kjo ndërmarrje është inkorporuar në përputhje me Rregulloren për Shoqëritë Tregtare.

“Rregullorja për Shoqëritë Tregtare” do të thotë Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/6 e datës 8 shkurt 2001, “mbi Shoqëritë Tregtare”, me ndryshimet dhe plotësimet e saj të bëra kohë pas kohe.

“Rregullorja mbi Ligjin Themelor të Punës” do të thotë Rregullorja e UNMIK-ut Nr.2001/27 e datës 8 Tetor 2001 “mbi Ligjin Themelor të Punës në Kosovë” me ndryshimet dhe plotësimet e saj të bëra kohë pas kohe.

“Rregullorja mbi Riorganizimin dhe Likuidimin e Ndërmarrjeve” do të thotë Rregullorja e UNMIK-ut Nr.2005/48 e datës 21 Tetor 2005 “mbi Riorganizimin dhe Likuidimin e Ndërmarrjeve dhe Pasurisë së tyre me Autorizimin Administrativ të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit” me ndryshimet dhe plotësimet e saj të bëra kohë pas kohe.

“Rregullorja mbi Transformimin e Pronës së Patundshme” do të thotë Rregullorja e UNMIK-ut Nr/2003/13 e datës 9 Maj 2003, “mbi Transformimin e së Drejtës për Përdorimin e Pronës së Patundshme Shoqërore”.

“Komision Shqyrtues” do të thotë një komision të themeluar sipas Nenit 24 të këtij ligji.

“Ndërmarrje në Pronësi Shoqërore” do të thotë një person juridik (përveç një ndërmarrje në pronësi publike) e cila:

a) me apo pas 1 Janarit 1989 (i) i nënshtrohet paragrafit 1 ose 2 të Nenit 2 të Ligjit mbi Ndërmarrjet, ose (ii) i nënshtrohet paragrafit 3 të Nenit 2 të Ligjit mbi Ndërmarrjet dhe

shumica e asetëve të së cilës kanë qenë në pronësi shoqërore ose shumica e kapitalit të së cilës ishte e përbërë nga kapitali shoqëror; dhe

b) është regjistruar ose është dashur të regjistrohej në Kosovë sipas ligjit të atëhershëm në fuqi.

“Dhoma e Posaçme” do të thotë Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës e themeluar në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut Rr. 2002/13 të datës 13 Qershor 2002, “mbi themelimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për Çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit” me ndryshimet dhe plotësimet e saj të bëra kohë pas kohe.

“Transformim” lidhur me personin juridik do të thotë cilado nga të mëposhtmet: bashkimi, transformimi, (ri-)regjistrimi, inkorporimi si shoqëri aksionare apo si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, si ortakëri apo si person tjetër juridik, falimentimi, likuidimi, paaftësia paguese, organizimi në formë të veçantë apo në subjekt tjetër ose çfarëdo ngjarje apo procesi tjetër përmes të cilit ndryshohen cilado nga të poshtëshënuarat lidhur me atë subjekt: identiteti ligjor, forma apo natyra, ose forma apo natyra e pronësisë apo kapitalit, selia, dhe nëse ngjarja apo procesi i tillë apo ndonjë pjesë e tij ka ndodhur në cilëndo kohë ndërmjet 22 Marsit 1989 dhe 13 Qershorit 2002.

3.2 Fjalët e cilësdo gjini të përdorura në këtë Rregullore nënkuptojnë edhe gjinitë e tjera dhe fjalët në numrin njëjës nënkuptojnë edhe numrin shumës dhe anasjelltas.

Neni 4 Referimet

Përveç nëse konteksti në mënyrë të qartë kërkon një interpretim tjetër, të gjitha referencat në këtë ligj ndaj një ligji, rregullore ose akti nënligjor, ose ndaj një dispozite të caktuar të tyre, duhet të interpretohen për të përfshirë të gjitha ndryshim plotësimet e tyre. Nëse ligji, rregullorja ose akti nënligjor i sipër cekur shfuqizohet dhe zëvendësohet me legjislacion pasardhës mbi të njëjtën fushë, referencat duhet të interpretohen për të nënkuptuar legjislacionin pasardhës, dhe sipas rastit, dispozitën përkatëse në legjislacionin pasardhës.

KREU II

Detyrat dhe kompetencat e Agjencisë

Neni 5 Ndërmarrjet nën administrimin e Agjencisë

5.1 (a) Agjencia është e autorizuar që të administrojë

(i) ndërmarrjet në pronësi shoqërore, pavarësisht nëse i janë nënshtruar transformimit apo jo; dhe

(ii) të gjitha asetet që ndodhen në territorin e Kosovës, pavarësisht a janë të organizuara si subjekt apo jo, të cilat kanë qenë pronë në pronësi shoqërore me ose para 22 Marsit 1989, pavarësisht nëse i janë nënshtruar transformimit apo jo, sipas Nenit 5.1(b) më poshtë; dhe

(iii) pjesët e vogla, pavarësisht nëse subjekti përkatës juridik i është nënshtruar transformimit.

(b) nëse një rregullore ose ligj i shpallur nga një autoritet publik në Kosovë pas 10 Qershorit 1999 i cakton përgjegjësinë për administrimin e aseteve të përcaktuara në nenin 5.1(a)(ii) një organi tjetër publik, , Agjencia nuk do të ketë autoritet mbi këto ndërmarrje duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të atij ligji ose rregullore.

5.2 Pavarësisht nga detyrimet e Agjencisë të përcaktuara në nenin 2.1, Agjencia mund të ndërmerr të gjitha veprimet dhe të ushtrojë të drejtat e përcaktuara në Ligjin në Fuqi në lidhje me pronën e Ndërmarrjeve e cila ndodhet jashtë territorit të Kosovës, ashtu si agjencia me arsye e konsideron të nevojshme, me kusht që këto prona të Ndërmarrjeve të mund të qasen nga Agjencia duke marrë parasysh burimet e saj të kufizuara administrative të përmendura në nenin 7.1. Gjatë marrjes së vendimit mbi një çështje të kësaj natyre, Agjencia duhet të marrë parasysh të gjitha politikat përkatëse të cilat mund të miratohen nga Qeveria ose Kuvendi i Kosovës në përputhje me Ligjin në Fuqi.

5.3 a) Nëse ndërmarrja i është nënshtruar transformimit, ky transformim nuk do të ndikojë në të drejtat dhe kompetencat e Agjencisë sipas neneve 6, 8 ose 9, përveç nëse:

(i) transformimi është bazuar dhe është kryer në përputhje të plotë me ligjin në fuqi, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm në, pagesën e kompensimit të plotë dhe lëshimin e aksioneve me rastin e transformimit, në shumën e paraparë sipas Ligjit në Fuqi dhe/ose ndonjë kontrate të vlefshme; dhe

(ii) transformimi nuk ka qenë diskriminues dhe nuk i ka shkelur parimet e Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut,

b) gjatë ushtrimit të të drejtave dhe kompetencave të saj sipas neneve 6, 8 dhe 9 në lidhje me një ndërmarrje e cila i është nënshtruar transformimit, Agjencia ka të drejtë të supozojë se transformimi nuk i përmbush të gjitha kushtet e përcaktuara në paragrafin (a) më sipër, përveç nëse Agjencia ka gatshëm në dispozicion prova bindëse të cilat vërtetojnë se transformimi i përmbush këto kushte. Në raste të këtilla zbatohet paragrafi (c) më poshtë.

c) nëse, në përputhje me paragrafin (b) më sipër, Agjencia konstaton se Transformimi i një Ndërmarrje ose Aseti i përmbush të gjitha kushtet e përcaktuara në paragrafin (a), do të zbatohen rregullat në vijim:

(i) nëse agjencia ka prova të gatshme në dispozicion, të cilat në mënyrë bindëse e bëjnë ndarjen e të drejtave të aksionarëve (ose pronësisë) mbi Ndërmarrjen (ose Asetin)ndërmjet kapitalit shoqëror (ose pronësisë) dhe kapitalit privat (ose pronësisë), Agjencia do ta ndërpresë ushtrimin e autoritetit mbi këtë Ndërmarrje (ose Aset) përveç për qëllime të: (A) ushtrimit të të gjitha të drejtave të aksionarit (ose pronës) në pronësi shoqërore mbi Ndërmarrjet (ose Asetin) të cilat janë përcaktuar në Ligjin në Fuqi (duke përfshirë të drejtën për shitjen e këtyre të drejtave); dhe (B) lëshimin për pronarët përkatës të të gjitha të drejtave në pronësi private të aksionarëve (ose pronësisë) mbi Ndërmarrjen (ose Asetin) përkatës, në përputhje me nenin 5.6 (iii);

(ii) në mungesë të këtyre provave, Agjencia do të vazhdojë të ushtrojë të drejtat dhe kompetencat e saj sipas neneve 6, 8 dhe 9 në lidhje me Ndërmarrjen ose Asetin, dhe nenet 5.4 deri 5.7 do të zbatohen.

5.4 Pas përfundimit të një veprimi të agjencisë të përmendur në Nenin 6.2 (b), (c) ose (d) i cili rezulton në shitjen e një Ndërmarrje ose Aseti nën autoritetin e Agjencisë, Pronarët e Ndërmarrjes ose Asetit - pasi që të jenë identifikuar pas përfundimit të veprimit të Agjencisë në përputhje dhe në bazë të provave të cilat janë të pranueshme sipas Ligjit në Fuqi - do të kenë të drejtat e pronarëve në të ardhurat të cilat rezultojnë nga shitja, pa paragjykuar të drejtat e kreditorëve dhe palëve të tjera të treta të interesuara, ndaj të ardhurave. Këto të drejta pronësore rregullohen sipas Nenit 5.6.

5.5 Agjencia do të konstatojë identitetin e Kreditorëve të Ndërmarrjeve dhe shumën e pretendimeve të tyre përmes vlerësimit të tyre në përputhje me Ligjin në Fuqi; Agjencia do t'i paguajë këta Kreditorë në përputhje me nenin 5.7.

5.6 Agjencia do të konstatojë identitetin e Pronarëve të Ndërmarrjeve ose Aseteve nën autoritetin e saj administrativ përmes vlerësimit të pretendimeve të tyre pronësore në përputhje me Ligjin në fuqi, si dhe:

(i) do t'u paguajë këtyre pronarëve (në përputhje me nenin 5.7) të ardhurat të cilat rezultojnë nga një veprim i Agjencisë sipas neni 6.2(b), nëse Agjencia paraprakisht e ka përfunduar këtë veprim; ose

(ii) do t'u paguajë këtyre Pronarëve (në përputhje me nenin 5.7) të Ardhurat të cilat rezultojnë nga likuidimi i Ndërmarrjes përkatëse sipas nenit 6.2 (c), nëse Agjencia paraprakisht e ka përfunduar likuidimin, ose

(iii) do t'i lirojë dhe do t'u transferojë këtyre pronarëve të gjitha interesat, të drejtat dhe dokumentet e tyre në Ndërmarrjen ose Asetin përkatës, nëse Agjencia paraprakisht nuk e ka përfunduar njërën nga masat e përcaktuara në nenin 6.2(b) ose nenin 6.2(c); dhe

(iv) do t'u paguajë këtyre pronarëve çfarëdo fonde të tjera të cilat mbahen në besim, në të mirë të pronarëve.

5.7 a) Agjencia do t'i konsolidojë dhe njëkohësisht do t'i shqyrtojë të gjitha pretendimet e pronarëve dhe kreditorëve të cilat janë paraqitur në lidhje me një Ndërmarrje ose Aset të caktuar për të cilën Agjencia paraprakisht e ka përfunduar një veprim të përcaktuar në nenin 6.2 (b) ose nenin 6.2 (c). Këto pretendime do të përmbushen ekskluzivisht me mjete nga të ardhurat përkatëse, sipas paragrafit (b) dhe në përputhje me Ligjin në Fuqi.

b) agjencia do t'i shpërndajë të ardhurat ndërmjet Kreditorëve dhe Pronarëve në bazë të, *mutatis mutandis*, prioriteteve të përcaktuara në nenin 44 të Rregullores për Riorganizimin dhe Likuidimin e Ndërmarrjeve; *sidoqoftë, me kusht që:*

(i) pretendimet të cilat rregulloren në bazë të nenit 44.1 (e) do të përmbushen ekskluzivisht nga mjetet e marra nga të ardhurat përkatëse;

(ii) klasa e pretendimeve që mund të ngrihen në bazë të nenit 44.1(f), përveç pretendimeve për rrogat e papaguara, përfshin pretendimet për pagesë për shkurtim nga puna të parashikuara ligjërisht, të ngritura nga punonjës të cilët janë shkurtuar si pasojë, apo në lidhje me një veprim të ndërmarrë nga Agjencia sipas nenit 6.1 ose 6.2; dhe

(iii) pas përmbushjes së pretendimeve të kreditorëve, të ardhurat e mbetura do t'u shpërndahen pronarëve të Ndërmarrjes në përputhje me nenin 44.1(h); megjithatë, secili pronar i Ndërmarrjes do të marrë një përqindje të të ardhurave të mbetura e cila është e barabartë me përqindjen e pronësisë së tij në Ndërmarrje.

5.8 Parimet e nenit 1, Protokollit 1, të Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut do të zbatohen plotësisht gjatë zbatimit të neneve 5.3, 5.4, 5.5 dhe 5.6.

Neni 6

Kompetencat administrative të Agjencisë mbi ndërmarrjet

6.1 Agjencia ka kompetenca administrative mbi të gjitha ndërmarrjet dhe asetet. Këto kompetenca përfshijnë të gjitha veprimet të cilat Agjencia i konsideron të arsyeshme dhe të nevojshme, brenda kufijve të burimeve administrative të Agjencisë, për ruajtjen ose rritjen e vlerës, shanseve për sukses ose qeverisjes së ndërmarrjes përkatëse, duke përfshirë:

- a) emërimin dhe zëvendësimin e kryesuesit, drejtorëve dhe menaxherëve të ndërmarrjes;
- b) konstituimin, konfirmimin ose riformimin e bordit mbikëqyrës, bordit menaxhues, këshillit të punëtorëve ose organit tjetër menaxhues apo mbikëqyrës të ndërmarrjes;
- c) ndryshimin e kompetencave të cilitdo person ose organ të përmendur në paragrafin (a) ose (b) më sipër;
- d) nxjerrjen e udhëzimeve lidhur me veprimtarinë e ndërmarrjes, në veçanti lidhur me politikën për menaxhim të shëndoshë financiar;
- e) marrjen përsipër të kontrollit të drejtpërdrejtë mbi ndërmarrjen, duke përfshirë llogaritë bankare dhe asetet, dhe administrimin e këtyre llogarive dhe asetëve veçmas nga llogaritë e Agjencisë;
- f) auditimin e jashtëm të ndërmarrjes në mënyrë të drejtpërdrejtë ose përmes agjentëve të autorizuar;
- g) urdhërimin e çdo nëpunësi, kontraktuesi ose ndërmjetësuesi tjetër afarist të ndërmarrjes, që të sigurojë informacionet që i posedon për ndërmarrjen e tillë;
- h) urdhërimin e çdo personi që ka kontroll mbi dokumentet e ndërmarrjes që të mundësojë qasje në këto dokumente për shqyrtim, kopjim dhe ruajtje;
- i) hyrjen dhe inspektimin e lokaleve të ndërmarrjes;
- j) aprovimin e planeve të biznesit dhe planeve të investimit të ndërmarrjes;
- k) nxjerrjen ose ndryshimin e akteve të themelimit, rregulloreve dhe dokumenteve të tjera përkatëse të ndërmarrjes;
- l) regjistrimin e ndërmarrjeve në Kosovë që nuk janë regjistruar në mënyrë adekuate;
- m) arritjen e marrëveshjeve për menaxhimin, rindërtimin ose riorganizimin e ndërmarrjeve;
- n) dhënien e koncesioneve ose kontratave të qirasë që lidhen me ndërmarrjet;
- o) themelimin e një apo më shumë korporatave ndihmëse të ndërmarrjeve që janë në pronësi të atyre ndërmarrjeve, por që administrohen nga Agjencia, në pajtim me Rregulloren mbi Shoqëritë Tregtare dhe transferimin e një pjese apo tërë pasurisë së ndërmarrjeve në këto korporata ndihmëse;
- p) transformimin e ndërmarrjeve në korporata;

- q) ristrukturimin e ndërmarrjes në disa ndërmarrje dhe/ose korporata dhe transferimin e pjesëshëm ose të plotë të asetëve të ndërmarrjes në korporatat ndihmëse;
- r) dhënien me nënkontratë të një pjese të veprimtarisë së ndërmarrjes; dhe
- s) inicimin e procedurës së riorganizimit ose likuidimit të ndërmarrjes ose përfaqësimit e ndërmarrjes në procedurat e riorganizimit ose likuidimit.

6.2 Në lidhje me Ndërmarrjet, Agjencia, përveç kompetencave nga neni 6.1, është e autorizuar që të ndërmerr veprimet në vijim të cilat Agjencia i konsideron të nevojshme:

- a) themelimin e një ose më shumë korporatave ndihmëse të ndërmarrjes dhe transferimin e një pjese apo tërë pasurisë së ndërmarrjes në këto korporata ndihmëse në pajtim me Nenin 8;
- b) shitjen e të gjitha apo një pjesë të aksioneve të korporatave ndihmëse të themeluara sipas paragrafit (a) më sipër, në pajtim me nenin 8;
- c) likuidimin e ndërmarrjeve të tilla në pajtim me nenin 9; dhe
- d) të disponojë me të ardhurat dhe asetet e tjera të ndërmarrjeve të tilla.

6.3 Rregullorja mbi Ligjin Themelor të Punës nuk do të zbatohet në lidhje me ndonjë veprim të ndërmarrë nga Agjencia nën autoritetin e këtij neni 6; *sidoqoftë, me kusht që* neni 12.2 (f) i kësaj Rregulloreje të përdoret për të përcaktuar shumën e pagesës për shkurtim nga puna që mundet të ngrihet si pretendim i vlefshëm sipas nenit 5.7 (b) (ii).

6.4 Gjatë ushtrimit të veprimeve të përcaktuara në paragrafët (b), (c) dhe (d) të Nenit 6.2, Agjencia do t'i përmbushë parimet e nenit 1, Protokollin 1 të Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut.

Neni 7 **Ushtrimi i kompetencave**

7.1 Përveç nëse Bordi nuk vendos ndryshe, Agjencia përmbush detyrat e parapara sipas këtij kapitulli, duke ushtruar mbikëqyrjen e menaxhimit të përgjithshëm mbi ndërmarrjen, brenda kufijve të burimeve të veta administrative.

7.2 Përveç nëse Bordi nuk vendos ndryshe, veprimtaria e përditshme afariste e ndërmarrjeve drejtohet nga organet menaxhuese dhe organet e tjera të ndërmarrjes, pa i cenuar kompetencat e Agjencisë sipas këtij ligji.

Neni 8 **Themelimi i korporatave ndihmëse të ndërmarrjeve**

8.1 Në emër të ndërmarrjes, Agjencia mund të themelojë një apo më shumë korporata ndihmëse dhe t'u transferojë këtyre korporatave të drejtat dhe interesat në Asetet e ndërmarrjes, pjesërisht ose plotësisht. Agjencia vendos për secilin rast veç e veç nëse dhe në ç' masë korporata ose korporatat e themeluara në këtë mënyrë do t'i marrin përsipër detyrimet e ndërmarrjes përkatëse. Aksionet e korporatës ose korporatave të themeluara në këtë mënyrë do të administrohen nga Agjencia në pajtim me këtë ligj. Nëse një kreditor paraqet pretendim

mbi një detyrim ose përgjegjësi e cila, sipas vendimit të Agjencisë përmendur në këtë paragraf, është marrë përsipër nga një Korporatë, Kreditori nuk do të ketë të drejtë në shpërndarje sipas neneve 5.5 dhe 5.7; Në vend të kësaj, Kreditori ka të drejtë që ta paraqesë pretendimin kundër Korporatës.

8.2 Procedurat sipas këtij neni udhëhiqen në pajtim me Rregulloren mbi organizatat Shoqëritë Tregtare, përveç faktit se kërkesat e marrëveshjes së themeluesve dhe themelimit nga neni 25 i Rregullores për Shoqëritë Tregtare nuk do të merren parasysh dhe se një deklarata e themeluesit e nënshkruar nga një përfaqësues i autorizuar i Agjencisë do të jetë zëvendësim i vlefshëm i marrëveshjes së themeluesve.

8.3 Agjencia mund të shesë dhe të transferojë një pjesë ose të gjitha aksionet në një korporatë ndihmëse të krijuar në pajtim me këtë nen, në emër të Ndërmarrjes e cila është pronare e këtyre aksioneve; këto shitje ose transfere do të paraprihen nga një procedurë e hapur dhe konkurruese e ofertimit. Afatet e njoftimit dhe periudhat e pritjes të përcaktuara në Rregulloren mbi Shoqëritë Tregtare nuk merren parasysh sa i përket mbledhjeve të aksionarëve.

8.4 Agjencia ka të drejtë të administrojë të ardhurat në para të gatshme ose aksionet të cilat rezultojnë nga shitjet e lejuara të aksioneve të një ndërmarrje e cila administrohet nga Agjencia.

8.5 Të ardhurat nga shitja e lejuar e aksioneve grumbullohen në ndërmarrjen e cila i ka qenë pronare e këtyre aksioneve, me kusht që shumat e tilla të mbahen në mirëbesim nga Agjencia dhe të shkojnë në dobi të kreditorëve dhe pronarëve të ndërmarrjes përkatëse.

Neni 9

Likuidimi vullnetar i ndërmarrjeve

9.1 Agjencia mund të iniciojë likuidimin vullnetar të një Ndërmarrje ose Aseti ose një pjese të saj, nëse mendon se procedura e tillë është në interes të kreditorëve ose pronarëve përkatës. Procesi i likuidimit do të ushtrohet në bazë të procedurave të përcaktuara në Rregulloren për Shoqëritë Tregtare, përveç nëse nuk është paraparë ndryshe në këtë ligj, dhe në Rregulloren për Riorganizimin dhe Likuidimin e Ndërmarrjeve ose Ligjet e tjera në Fuqi.

9.2 Të gjitha kompetencat e organeve menaxhuese dhe mbikëqyrëse të ndërmarrjeve të tilla i kalohen komisionit të likuidimit, që themelohet në pajtim me nenin 39 të Rregullores mbi Shoqëritë Tregtare, përveçse kur Agjencia ka kompetenca për të emëruar anëtarët e një komisioni të tillë të likuidimit përveç nëse nuk është përcaktuar ndryshe më poshtë. Secili komision i likuidimit do të ketë një anëtar ndërkombëtar, i cili emërohet nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar. Anëtarët e tjerë, të cilët duhet të kenë përvojë përkatëse, emërohen nga Agjencia, e cila duhet të sigurojë që një numër i duhur i anëtarëve të jenë nga komunitetet jo-Shqiptare në Kosovë. Secili komision i likuidimit duhet të ketë së paku një anëtar nga komunitetet jo-Shqiptare në Kosovë.

9.3 Çfarëdo padie gjyqësore kundër një ndërmarrje e cila është subjekt i likuidimit sipas këtij neni do të pezullohet me rastin e paraqitjes së kërkesës nga Agjencia në gjykatën e vendit ku është paraqitur padia. Kërkesës së tillë i duhet bashkëngjitur:

- a) dëshmia për dorëzimin e njoftimit të përshkruar në nenin 39.3 të Rregullores mbi shoqëritë Tregtare;
- b) dëshmia për publikimin e informatave të përfshira në atë njoftim në një publikim kryesor në gjuhën shqipe me tirazh të madh në Kosovë, një herë në javë për dy javë rresht dhe në një publikim kryesor në gjuhën serbe, në pajtim me kriteret e përcaktuara nga Bordi;
- c) dëshmia për paraqitjen e Agjencisë në faqen e internetit në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze, nëse ekziston faqja e internetit në kohën e Likuidimit; dhe
- d) dëshmia për njoftimin e subjekteve për të cilat Agjencia beson ose ka arsye për të besuar se kanë pretendim ndaj ndërmarrjes përkatëse.

9.4 Pas paraqitjes së kërkesës nga Agjencia, Dhoma e Posaçme mund të anulojë çfarëdo transaksioni të ndërmarrjes, e cila i është nënshtruar procesit të likuidimit sipas këtij ligji, nëse transaksioni është bërë më pak se nëntëdhjetë (90) ditë para datës së publikimit të dytë të përshkruar në nenin 9.3 (b).

9.5 Secili komision i likuidimit është pjesë integrale e Agjencisë. Të gjitha veprimet apo mosveprimet e komisionit të likuidimit janë veprimet dhe mosveprimet e Agjencisë. Secili person që punon, apo është i angazhuar apo emëruar të ndihmojë në komisionin e likuidimit është ‘person i punësuar apo angazhuar nga Agjencia’ sipas kuptimit të nenit 18.5

Neni 10

Politika operative

10.1 Bordi nxjerr politikën operative për udhëheqjen e Agjencisë në ushtrimin e kompetencave të saj, sipas këtij kapitulli, me qëllim të:

- a) sigurimit të pajtueshmërisë me detyrat e Agjencisë sipas këtij ligji dhe Ligjit në Fuqi;
- b) në kuadër të burimeve administrative të Agjencisë, të sigurojë marrjen e masave të arsyeshme për ruajtjen dhe rritjen e vlerës, shansit për sukses dhe qeverisjes së ndërmarrjeve; dhe
- c) shpërndarjen e resurseve të kufizuara administrative të Agjencisë në veprimtari që me arsye pritet se do të rrisin vlerën e një Ndërmarrje.

10.2 Përkitazi me ushtrimin e kompetencave të Agjencisë sipas nenit 6.2, politikat operative:

- a) caktojnë rregulla transparente dhe të njëtrajtshme lidhur me procesin e ofertimit të përmendur në nenin 8.3, me qëllim të sigurimit të konkurrencës së drejtë ndërmjet ofertuesve, fitimit të vlerës së drejtë të tregut për aksionet e korporatës, si dhe pagesën e shpenzimeve të transaksioneve. Rregullat e përcaktuara në këtë mënyrë duhet të vendosen në dispozicion të publikut;
- b) përkitazi me kompetencat e Agjencisë nga paragrafët (b), (c) dhe (d) të nenit 6.2, caktojnë procedurat me qëllim të sigurimit të përputhshmërisë së Agjencisë me parimet e nenit 1, Protokollin 1 të Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut, ashtu siç kërkohet me nenin 6.3, duke përfshirë edhe proceset lidhur me çështjet që kërkojnë procese të menjëhershme, nxjerrjen e njoftimeve dhe kompensimin adekuat.

10.3 Politikat operative përfshijnë procedura për njoftimin e publikut mbi veprimet e Agjencisë. Në rastin e transaksioneve sipas:

- a) neneve 6.1 (p), (q), (s) dhe 6.2 (a) deri në (c);
- b) nenit 6.1 (n) kur këto koncesione apo kontrata qiradhënieje kanë të bëjnë me një pjesë të konsiderueshme të veprimtarive më të rëndësishme të ndërmarrjes, ashtu siç është përcaktuar në politikat operative; dhe
- c) nenit 6.2 (d) kur shitja e tillë përfshin një pjesë të konsiderueshme të pasurisë së përgjithshme të ndërmarrjes, siç është përcaktuar në politikat operative dhe procedurat e tilla duhet të sigurojnë që Agjencia të nxjerrë njoftimin për transaksionin në një botim kryesor në gjuhën shqipe me tirazh të madh në Kosovë dhe një ose më shumë botime kryesore në gjuhën serbe së paku dy javë para se transaksioni i tillë të finalizohet dhe të ketë fuqi ligjore.

10.4 Politikat operative vendosin standarde për qeverisje të mirë të korporatave, të cilat Agjencia ua imponon ndërmarrjeve në një masë të realizueshme. Në veçanti këto standarde duhet:

- a) Të nxisin respektimin e kërkesave të raportimit financiar sipas ligjit në fuqi;
- b) Të sigurojnë auditime vjetore të jashtme të ndërmarrjeve në pajtim me ligjin në fuqi; dhe
- c) Të sigurojnë mbrojtje kundër keqpërdorimit të kompetencave menaxhuese, duke përfshirë, por pa u kufizuar në përhapjen e informacioneve konfidenciale, shitjen veçmas të pasurive të ndërmarrjes me qëllim fitimi personal, pasurinë dhe përvetësimin e fitimit.

KREU III

Organizimi dhe menaxhimi

Neni 11 Struktura organizative

11.1 Agjencia ka Bordin e Drejtorëve, Drejtorin Menaxhues dhe dy Zëvendës Drejtorë Menaxhues, Drejtorin e Sekretarisë Ekzekutive si dhe personelin profesional dhe teknik.

11.2 Bordi i ka të gjitha kompetencat e Agjencisë. Bordi mund t'ia delegojë ushtrimin e kompetencave të veta Drejtorit Menaxhues, përveç kompetencave të rezervuara për Bordin sipas Nenit 15.

11.3 Drejtori Menaxhues është kryeshefi ekzekutiv i Agjencisë. Drejtori Menaxhues dhe dy Zëvendës Drejtorët Menaxhues i ushtrojnë kompetencat e Agjencisë të cilat u janë dhënë atyre nga Bordi ose nga ky ligj.

11.4 Drejtori Menaxhues, nën kontrollin e përgjithshëm të Bordit, drejton veprimtarinë e zakonshme të Agjencisë. Drejtori Menaxhues është përgjegjës për organizimin, emërimin dhe shkarkimin e personelit, përveç për emërimin dhe shkarkimin e dy Zëvendës Drejtorëve Menaxhues dhe personelit tjetër që mund të caktohet nga Bordi. Drejtori Menaxhues ushtron kompetencat e tjera që mund t'i delegohen nga Bordi.

11.5 Sekretaria Ekzekutive do t'i sigurojë Bordit të gjitha informatat e nevojshme për ushtrimin e funksioneve dhe mbajtjen e takimeve të Bordit, si dhe do të ushtrojë të gjitha funksionet e tjera të përcaktuara në rregullore.

Neni 12 Përbërja e Bordit

12.1 Bordi përbëhet nga tetë Drejtorë, duke përfshirë Drejtorin Menaxhues.

12.2 Kuvendi i Kosovës do të emërojë pesë Drejtorë, duke përfshirë një përfaqësues nga një komunitet jo-Shqiptar si dhe Kryetarin e Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës, dhe të përcaktojë njërin nga të emëruarit që të shërbejë si Kryesues i Bordit.

12.3 Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar do të emërojë tre ndërkombëtarë si Drejtorë të Bordit dhe një ndërkombëtar si Drejtor të Sekretarisë Ekzekutive të Bordit, i cili nuk shërben si anëtar i Bordit. Bordi emëron Drejtorin Menaxhues të Agjencisë nga radhët e veta. Bordi po ashtu do të emërojë njërin nga anëtarët e tij, përveç Kryesuesit dhe Drejtorit Menaxhues, që të shërbejë si Zëvendës Kryesues.

12.4 Drejtorët do të shërbejnë në Bord në cilësi personale dhe marrin pjesë personalisht në takimet e Bordit.

12.5 Asnjë person nuk mund të bëhet ose të mbetet Drejtor nëse:

- a) është dënuar për kryerje të veprës penale të mashtrimit, pas një procedure përkatëse dhe në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe Kosovare;
- b) është përjashtuar ose suspenduar nga ushtrimi i mëtutjeshëm i profesionit të tij për shkak të shkeljeve të rënda profesionale pas një procedure përkatëse dhe në pajtim me standardet ndërkombëtare;
- c) ka ose përfiton interes të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në një ndërmarrje ose në një person apo subjekt i cili pretendon një interes pronësor në një ndërmarrje; dhe
- d) ka interesa ose angazhohet në veprimtari të cilat janë në kundërshtim me përgjegjësitë e tij sipas nenit 15.

12.6 Për të pasur të drejtën e zgjedhjes si Drejtor, personi duhet të ketë së paku pesë vite përvojë pune në fushën e administratës publike, juridik, kontabilitet, financa, menaxhim të ndërmarrjeve, punë rregullatore ose përvojë tjetër përkatëse.

12.7 Drejtorët mund të caktohen në Agjenci nga institucionet tjera. Në këto raste, kompensimi i tyre, nëse ka kompensim, dhe kushtet e tyre të shërbimit varen nga kontrata e tyre me institucionin caktues. Privilegjet dhe imuniteti i Drejtorëve të caktuar, nëse ka të këtillë, varet nga privilegjet dhe imuniteti i institucionit caktues dhe marrëdhënia kontraktuese e Drejtorit me institucionin përkatës. Ky rregull zbatohet po ashtu për tatimin e Drejtorëve të caktuar në Kosovë.

Neni 13

Mandati dhe Detyrat e Drejtorëve

13.1 Drejtorët, përveç kryesuesit dhe zëvendës kryesuesit të Bordit si dhe Drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive të Bordit emërohen me mandate të përsëritshme dyvjeçare.

13.2 Drejtorët nuk marrin kompensim për pjesëmarrje në mbledhjet e Bordit; mirëpo ata mund të kompensohen për shpenzimet e arsyeshme të bëra në lidhje me pjesëmarrjen në mbledhjet e Bordit si dhe shpenzimet e arsyeshme të bëra për përmbushjen e funksioneve të tjera zyrtare në emër të Agjencisë.

13.3 Drejtorët do t'i kryejnë detyrimet e tyre në mënyrë të paanshme duke synuar për përmbushjen e qëllimeve të Agjencisë të përcaktuara në nenin 2. Ata nuk duhet të pranojnë udhëzime lidhur me ushtrimin e detyrave të tyre.

13.4 Drejtorët kanë ndaj Agjencisë detyrimin e njëjtë për mirëbesim sikurse Drejtorët e Shoqërive Aksionare sipas Rregullores për Shoqëritë Tregtare.

13.5 Drejtorët mund të shkarkohen nga detyra nga subjekti i cili i ka emëruar nëse ata:

- a) e humbin të drejtën për të shërbyer si Drejtor sipas nenit 12.5;
- b) e shfrytëzojnë postin në dobi të ndonjë personi apo subjekti tjetër përveç Agjencisë;
- c) bëhen të paafte për kryerjen e detyrave të tyre së paku për një periudhë tremujore;
- d) nuk pajtohen me ndonjë vendim të marrë sipas nenit 5; ose
- e) i shkelin detyrat e tyre.

Neni 14

Procedurat e Bordit

14.1 Procedurat e Bordit do të caktohen në rregullore të Agjencisë të miratuara nga Bordi.

14.2 Mbledhjet e rregullta të Bordit do të konvokohen së paku një herë në muaj. Kryesuesi mund të thërrasë mbledhje të tjera në çdo kohë dhe këtë e bën me kërkesën e së paku dy drejtorëve.

14.3 Dy donatorët më të mëdhenj ndërkombëtarë të Agjencisë do të kenë të drejtën e pjesëmarrjes në të gjitha mbledhjet e Bordit në cilësinë e vëzhguesve pa të drejtë vote.

14.4 Bordi konsiderohet se ka kuorum nëse janë të pranishëm së paku pesë drejtorë, së paku njëri ndër të cilët duhet të jetë Drejtor ndërkombëtar.

14.5 Vendimet e Bordit do të merren me konsensus dhe nëse konsensusi nuk mund të arrihet, me votim.

14.6 Vendimet merren me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të pranishëm, nëse nuk është paraparë ndryshe në këtë ligj ose në rregulloret e Agjencisë.

14.7 Kur, për një vendim të caktuar, sipas këtij ligji ose rregulloreve të Agjencisë nevojitet shumica e kualifikuar, vendimi do të merret me së paku pesë vota pozitive. Të gjitha vendimet mbi pagesat të cilat duhet të bëhen sipas nenit 15.2(g) duhet të marrin votën pozitive të tre Drejtorëve Ndërkombëtarë.

14.8 Çdo drejtor ka nga një votë. Në rast të ndarjes së barabartë të votave, vota e kryesuesit është vendimtare.

14.9 Pavarësisht nga nenet 14.6 dhe 14.7, tre anëtarët ndërkombëtarë të Bordit në mënyrë të përbashkët dhe unanime mund të pezullojnë cilindo vendim të marrë nga Bordi, nëse vendosin se vendimi është në kundërshtim me parimet e përcaktuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut duke përfshirë të gjitha Protokollet e kësaj konvente ose Ligjin në Fuqi, dhe duhet ta paraqesin çështjen për vendim nga Dhoma e Posaçme. Dhoma e Posaçme i merr këto vendime në mënyrë urgjente. Vendimi i sipër cekur i Bordit mbetet i pezulluar deri në marrjen e vendimit nga Dhoma e Posaçme.

14.10 Rregulloret mund t'i përcaktojnë vendimet që mund të merren vetëm nga kryesuesi (apo zëvendësi i tij). Në raste emergjente kryesuesi dhe Zëvendës Kryesuesi, duke vepruar së bashku, mund të marrin vendime të cilat më pas i nënshtrohen konfirmimit nga Bordi në mbledhjen e ardhshme të tij.

14.11 Drejtori i Sekretarisë Ekzekutive të Bordit ka detyrat e përcaktuara në rregullore.

Neni 15 **Përgjegjësitë e Bordit**

15.1 Bordi ka përgjegjësi të përgjithshme për aktivitetet e Agjencisë dhe për përmbushjen e kësaj përgjegjësie ndërmerr veprimet e duhura apo të lejuara me këtë ligj.

15.2 Vendimet e poshtëshënuara të Bordit do të merren me shumicën e kualifikuar dhe nuk mund t'i delegohen drejtorit menaxhues:

- a) miratimi i aktit të themelimit, rregulloreve, strukturës së përgjithshme organizative, politikës financiare dhe të auditimit, politikës së personelit dhe punësimit të Agjencisë;
- b) miratimi i politikës operative sipas nenit 10;
- c) emërimi apo shkarkimi i një zëvendësdrejtori menaxhues ose ndonjë zyrtari tjetër, emërimi i të cilëve është rezervuar për Bordin;
- d) konstituimi, konfirmimi ose përbërja e Bordit mbikëqyrës, këshillit të punëtorëve ose organit tjetër mbikëqyrës të ndërmarrjes dhe çdo përcaktim apo ndryshim i kompetencave dhe përgjegjësive të organit të tillë;
- e) vendosja e një ndërmarrje nën administrimin e drejtpërdrejtë të Agjencisë sipas Nenit 6.1(e);
- f) miratimi apo ndryshimi i aktit të themelimit, rregulloreve ose dokumenteve të ngjashme të një ndërmarrje;
- g) vendimi për pagesat të cilat duhet të bëhen nga të ardhurat që rezultojnë nga aktivitetet e Agjencisë sipas Neneve 8 dhe 9 ose që mbahen në mirëbesim në të mirë të Kreditorëve ose

Pronarëve, përveç nëse Dhoma e Posaçme paraprakisht ka nxjerrë një vendim i cili duhet të zbatohet menjëherë dhe i cili kërkon bërjen e këtyre pagesave;

h) nënshkrimi i një marrëveshje për menaxhimin, rindërtimin ose riorganizimin e ndërmarrjes ose një marrëveshje për qiradhënie lidhur me ndonjë ndërmarrje në pajtim me nenin 6.1(m);

i) dhënia e koncesioneve ose qiradhënia e pronës, të drejtave ose veprimtarive të ndërmarrjes sipas nenit 6.1 (n);

j) miratimi i planeve për riorganizimin ose ristrukturimin e ndërmarrjes;

k) miratimi i krijimit të një ose më shumë korporatave nga një ndërmarrje sipas nenit 8;

l) shitja ose transferi i një pjese ose i të gjitha aksioneve të një korporate të krijuar sipas paragrafit (k) më sipër një pale të jashtme;

m) vendimi për likuidimin e një ndërmarrje ose pjesëve të saj sipas nenit 9;

n) vendimi për fillimin e procedurës së riorganizimit ose likuidimit të një Ndërmarrje në përputhje me Rregulloren për Riorganizimin dhe Likuidimin e Ndërmarrjeve;

o) miratimi i buxhetit dhe i planeve të punës së Agjencisë për vitin e ardhshëm kalendarik;

p) miratimi i punës (performancës) së menaxhmentit në bazë të raportit vjetor të auditimit;

q) vendimi nëse një ndërmarrje e veçantë ose një grup i caktuar i ndërmarrjeve do të konsiderohet nga Agjencia se i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 5; dhe

r) vendosja e procedurave, funksioneve ose njërive të kontrollit të brendshëm në Agjenci të cilat Bordi i konsideron të nevojshme.

15.3 Agjencia i merr vendimet për privatizimin ose likuidimin e Ndërmarrjeve vetëm pas konsultimit me zyrtarët e komunave në të cilat ndodhen ndërmarrjet përkatëse.

Neni 16 **Menaxhmenti dhe personeli**

16.1 Drejtori Menaxhues me ndihmën e dy Zëvendës drejtorëve menaxhues është përgjegjës për:

a) kryerjen e të gjitha funksioneve që i janë deleguar atij nga Bordi;

b) zhvillimin e veprimtarisë së rregullt të Agjencisë në pajtim me politikën dhe udhëzimet që mund të nxirren nga Bordi;

c) organizimin, emërimin dhe largimin nga puna të personelit (përveç Zëvendës drejtorëve menaxhues dhe zyrtarëve të tjerë, emërimin e të cilëve Bordi e ka rezervuar për vete) në pajtim me vendimet e marra ose udhëzimet e nxjerra nga Bordi;

d) përgatitjen e mbledhjeve të Bordit dhe sigurimin e zbatimit të vendimeve të Bordit; dhe

e) kryerjen e çfarëdo funksioni në marrëveshje me Bordin në pajtim me nenin 2.2 (b).

16.2 Drejtori menaxhues i raporton Bordit dhe i përgjigjet vetëm atij dhe asnjë pale tjetër.

16.3 Drejtori menaxhues dhe dy Zëvendësdrejtorët menaxhues emërohen nga Bordi pas propozimit nga kryesuesi. Ata në çdo kohë mund të shkarkohen nga Bordi. Bordi vendosë për kompensimin dhe kushtet e tjera të shërbimit të drejtorit dhe Zëvendësdrejtorëve menaxhues, pa cenuar nenin 16.5 më poshtë.

16.4 Personat të cilët nuk kanë të drejtë për t'u emëruar për drejtor të Bordit sipas nenit 13.4 gjithashtu nuk kanë të drejtë të emërohen për Drejtor Menaxhues ose Zëvendësdrejtor menaxhues. Ata gjithashtu nuk kanë të drejtë të zgjidhen në këto poste nëse mbajnë një post publik ose janë anëtarë të një organi ekzekutiv në një parti politike.

16.5 Menaxhmeni dhe personeli tjetër i Agjencisë mund të caktohen në Agjenci nga institucionet e tjera. Në rastet e tilla, kompensimi dhe kushtet e tyre të shërbimit do të varen nga kontrata e tyre me institucionin i cili i dërgon. Privilegjet dhe imuniteti i personelit të caktuar, nëse kanë, varen nga privilegjet dhe imunitetet e institucionit që i dërgon dhe nga marrëdhënia kontraktuese e personelit të transferuar me atë institucion. Ky rregull zbatohet po ashtu për tatimin e Drejtorëve të caktuar në Kosovë.

16.6 Gjatë kryerjes së detyrave të tyre, menaxhmenti dhe personeli i përgjigjen vetëm Agjencisë. Ata nuk duhet të marrin kurrfarë udhëzimesh sa i përket kryerjes së detyrave të tyre nga asnjë autoritet tjetër përveç Bordit ose nga eprori i tyre hierarkik në Agjenci.

16.7 Menaxhmenti dhe personeli duhet ta ruajnë fshehtësinë e informatave të fituara gjatë shërbimit të tyre në Agjenci, por edhe pas shërbimit të tyre në Agjenci.

16.8 Menaxhmenti dhe personeli nuk duhet të kenë interes të drejtëpërdrejtë ose të tërthortë në një ndërmarrje apo në ndonjë palë e cila pretendon një interes në atë ndërmarrje.. Menaxhmentit dhe personelit gjithashtu i ndalohet marrja e përfitimeve nga çdo palë tjetër përveç nga Agjencia për çdo veprim ose mosveprim të Agjencisë, pa cenuar nenin 16.5.

16.9 Menaxhmenti dhe personeli kanë ndaj Agjencisë detyrimin e njëjtë për mirëbesim, kujdes dhe dilijencë sikurse zyrtarët, menaxhmenti dhe personeli i shoqërive aksionare sipas Rregullores për Shoqëritë Tregtare.

16.10 Bordi, menaxhmenti dhe personeli nuk i përgjigjen asnjë pale tjetër për çdo veprim ose mosveprim të bërë në emër të Agjencisë, përveç Agjencisë brenda kompetencave që u janë dhënë atyre nga Agjencia. Bordi, menaxhmenti dhe personeli janë përgjegjës ndaj Agjencisë për çdo mosrespektim të detyrave të tyre sipas këtij ligji ose sipas kontratave të tyre me Agjencinë, pa cenuar nenin 16.5.

KREU IV

Dispozitat financiare

Neni 17

Kapitali Themeltar dhe Financimi

17.1 Agjencia do të ketë kapitalin themeltar në shumë prej 10 milionë euro (10.000.000 €), prej të cilave një milion (1.000.000 €) euro do të paguhet me të holla të gatshme ose në natyrë; pjesa e mbetur mund të kërkohet nga Bordi në kohën dhe në shumën e nevojshme për

përmbushjen e detyrimeve të Agjencisë. Kapitali themeltar i Agjencisë mund të rritet nga Kuvendi i Kosovës me fonde nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës në përputhje me Ligjin në Fuqi, dhe nuk mund të reduktohet. As Republika e Kosovës dhe as Buxheti i Konsoliduar i Kosovës nuk janë përgjegjëse për detyrimet e Agjencisë.

17.2 Agjencia do të financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës në përputhje me ligjin në fuqi, dhe mund të pranojë fonde ose financim nga palë të treta.

Neni 18

Detyrimet, Diligjenca dhe Përgjegjësitë e Agjencisë

18.1 Çdo detyrim i shkaktuar nga Agjencia, qoftë me kontratë ose me anë të veprimit të ligjit do të kufizohet vetëm në asetet e Agjencisë, plus pjesa e papaguar e kapitalit nominal të saj. Agjencia nuk është përgjegjëse për kurrfarë borxhi që lidhet me asetet e trustit dhe asetet e trustit nuk mund të preken nga çfarëdo borxhi i Agjencisë.

18.2 Agjencia nuk është përgjegjëse për kurrfarë borxhi, veprimi ose mosveprimi që i atribuohet një ndërmarrje dhe asnjë ndërmarrje nuk është përgjegjëse për kurrfarë borxhi, veprimi ose mosveprimi që i atribuohet Agjencisë. Agjencia nuk është përgjegjëse për kurrfarë veprimi ose mosveprimi të drejtorëve, menaxherëve ose personave të tjerë kontrollues të ndërmarrjeve pavarësisht se a janë emëruar apo jo ata drejtorë, menaxherë a persona të tjerë kontrollues të ndërmarrjes nga Agjencia.

18.3 Llogaritë dhe asetet e tjera të ndërmarrjeve që administrohen nga Agjencia do të mbahen në mirëbesim veçmas nga njëra-tjetra dhe veçmas nga llogaritë dhe asetet e tjera të Agjencisë. Në përputhje me kritere të arsyeshme të investimit, fondet të cilat mbahen në mirëbesim nga Agjencia do të investohen në letra me vlerë dhe instrumente të tjera financiare të klasifikuara nga agjenci ndërkombëtare të klasifikimit si letra me vlerë dhe instrumente financiare për investim.

18.4 Agjencia në asnjë rast nuk përgjigjet për dëmet që janë si rrjedhim i tërthortë ose si pasojë e masave ndëshkuese.

18.5 Asnjë person i angazhuar ose i punësuar nga Agjencia dhe asnjë person i cili mban një pozitë menaxheriale ose të drejtorit në Agjenci ose në lidhje me Agjencinë, nuk mban përgjegjësi personale të çfarëdo lloji ndaj cilësdo palë të tretë për dëmet të cilat i janë shkaktuar ose pretendohen të jenë shkaktuar nga pala e tretë si rezultat i një veprimi ose lëshimi të Agjencisë ose një veprimi ose lëshimi të personelit, menaxhmentit ose Bordit të Drejtorëve të Agjencisë, nëse ky veprim ose lëshim është bërë gjatë zbatimit ose ekzekutimit të autoritetit dhe përgjegjësisive të Agjencisë të përcaktuara në këtë ligj ose cilitdo element tjetër të ligjit në fuqi në Kosovë ose si pasojë e zbatimit të një interpretimi të arsyeshëm dhe jo qëllimkeq të këtyre autoriteteve dhe përgjegjësisive. Të gjitha përgjegjësitë për dëmet e shkaktuara në këtë mënyrë janë përgjegjësi ekskluzive të Agjencisë. Agjencia është e detyruar që t'i sigurojë dhe mbrojë fuqishëm personelin, menaxherët ose drejtorët kundër të cilëve është ngritur një akuzë për këto dëme.

Neni 19

Politika financiare

19.1 Bordi i nxjerr politikat financiare me qëllim që Agjencia ta kryejë aktivitetin e saj në pajtim me praktikat e shëndosha dhe të arsyeshme të menaxhimit dhe t'i realizojë zotimet e veta financiare pa kërkuar kapitalin e papaguar sipas Nenit 17. Këto politika mund t'i mundësojnë Agjencisë që të kërkojë pagesa administrative, pagesa të transaksioneve dhe shërbimeve nga ndërmarrjet, korporatat dhe nga çdo shfrytëzues tjetër i aktiviteteve të Agjencisë me kusht që këto pagesa të jenë transparente, jo-diskriminuese dhe të arsyeshme.

19.2 Të gjitha të hyrat e mbledhura nga Agjencia si rezultat i aktiviteteve të saj sipas Nenit 8 dhe 9 të këtij ligji dhe të cilat mbahen në mirëbesim për t'ju shpërndarë Kreditorëve dhe Pronarëve do të investohen nga agjencia në llogari, instrumente ose mënyra të tjera të investimit të cilat janë ranguar për investim nga agjenci ndërkombëtare të rangimit dhe në përputhje me kriteret e arsyeshme dhe të matura të investimit.

Neni 20

Raportet, buxheti dhe llogaritë

20.1 Bordi i dorëzon Kuvendit të Kosovës dhe i bën publike raportet tremujore të cilat e përmbledhin aktivitetin e Agjencisë dhe i pasqyrojnë rezultatet financiare.

20.2 Bordi i dorëzon Kuvendit të Kosovës dhe do të bëjë publike një raport vjetor të Agjencisë i cili duhet të përfshijë:

- a) pasqyrat financiare të llogarive të Agjencisë;
- b) veçmas nga llogaritë e Agjencisë, pasqyrat financiare të llogarive dhe asetëve e cila mbahet nga Agjencia në mirëbesim;
- c) listën e ndërmarrjeve që janë vënë nën administrimin e drejtpërdrejtë të Agjencisë në pajtim me nenin 6.1;
- d) listën e transaksioneve të kryera sipas nenit 8 të realizuara gjatë vitit për të cilin raportohet dhe për transaksionet e mbetura pezull;
- e) listën e ndërmarrjeve të likuiduara sipas nenit 9; dhe
- f) listën e ndërmarrjeve ndaj të cilave është filluar procedura e riorganizimit.

20.3 Drejtori Menaxhues duhet të përgatisë buxhetin vjetor të të hyrave dhe shpenzimeve të përlllogaritura të Agjencisë si dhe një plan të punës i cili përfshin të gjitha aktivitetet e Agjencisë, për miratim nga Bordi.

Neni 21

Ndarja e të hyrave neto

Bordi vendos për ndarjen e të hyrave neto të Agjencisë në bazë të rekomandimit të drejtorit menaxhues. Konform praktikave të arsyeshme të menaxhimit, të hyrat e tilla do të ndahen për rezerva. Pjesa e mbetur do të grumbullohet në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

Neni 22

Trajtimi i taksave

22.1 Të ardhurat dhe prona e Agjencisë është e përjashtuar nga tatimi, me kusht që përjashtimi i tillë të mos vlejë për ndërmarrjet, korporatat, llogaritë dhe pasurinë tjetër të administruar nga Agjencia si agjenci mirëbesimi.

22.2 Transferi i pasurisë dhe shitja e aksioneve në pajtim me nenin 8 dhe 9 nuk i nënshtrohet tatimit mbi vlerën e shtuar.

KREU V

Përgjegjësia dhe Komisionet Shqyrtuese

Neni 23

Përgjegjësia e Bordit, Menaxhmentit dhe Personelit

23.1 Bordi do të ushtrojë gjykim të pavarur gjatë ushtrimit të funksioneve dhe përgjegjësive të tij sipas këtij ligji.

23.2 Bordi kolektivisht dhe drejtorët individualisht janë përgjegjës në çdo kohë për përputhjen e Agjencisë me:

- (i) këtë ligj;
- (ii) ligjet e tjera të aplikueshme në Kosovë;
- (iii) aktin themelues, rregulloret, politikat operative, financiare dhe të personelit si dhe procedurat e punës së Agjencisë, përveç nëse ato janë modifikuar ose shfuqizuar në pajtim me këtë ligj; dhe
- (iv) cilado marrëveshje ndërkombëtare që ndërlidhen me Kosovën dhe që i transferojnë funksione ose detyrime Agjencisë.

23.3 Detyrat dhe përgjegjësitë e Menaxhmentit zbatohen nga Bordi. Detyrat dhe përgjegjësitë e personelit zbatohen nga Drejtori Menaxhues. Të gjitha kërkesat për shqyrtimin ligjor të masave të zbatimit të marra, të pranuar ose kundërshtuara nga Bordi do të paraqiten drejtpërdrejt para Dhomës së Veçantë.

Neni 24

Komisionet e Shqyrtimit

24.1 Në bazë të numrit të ankesave të pranuar dhe vendndodhjes së Ndërmarrjeve ose Aseteve me të cilat ndërlidhen ato ankesa, Agjencia do të themelojë një numër të caktuar të Komisioneve për Shqyrtimin e Ankesave. Të gjitha komisionet e formuara në këtë mënyrë do të pajisen me të gjitha burimet e nevojshme për shqyrtimin e ankesave të paraqitura në

Agjenci nga personat e dëmtuar nga një vendim, veprim, mos veprim ose lëshim i Agjencisë ose një komisioni të likuidimit.

24.2 Secili Komision Shqyrtues do të ketë tre anëtarë, njëri ndër të cilët është anëtar ndërkombëtar i emëruar nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar dhe i cili kryeson Komisionin e Shqyrtimit. Të gjithë anëtarët e tjerë të Komisionit Shqyrtues do të emërohen nga Agjencia, e cila duhet të sigurojë që një numër adekuat i anëtarëve të emërohen nga komunitetet jo-Shqiptare të Kosovës ku secili Komision i Shqyrtues duhet të ketë së paku një anëtar nga një komunitet jo-Shqiptar në Kosovë. Anëtarët e Komisioneve Shqyrtuese do të zgjidhen nga personat të cilët kanë kualifikime përkatëse juridike ose përvojë pune në insolvencë, likuidim, tregti, financa ose kontabilitet dhe të cilët nuk kanë interesa të tjera që bien ndesh me detyrat e tyre; në veçanti, anëtarët e Komisioneve Shqyrtuese nuk duhet të jenë anëtarë të ndonjë komisioni për likuidim të themeluar nga Agjencia.

24.3 Çdo person ose subjekt i dëmtuar nga një veprim ose lëshim i Agjencisë ose një komisioni për likuidim ka të drejtë të paraqesë një kërkesë me shkrim për shqyrtimin e veprimit ose vendimit nga një Komision Shqyrtues. Kërkesa duhet të bëhet brenda gjashtëdhjetë ditëve pasi që pala ankuese të ketë kuptuar ose me arsye është dashur ta ketë kuptuar veprimin ose vendimin. Nëse Komisioni Shqyrtues nuk merr vendim brenda gjashtëdhjetë ditëve – ose brenda një periudhe më të gjatë kohore të përcaktuar në përputhje me nenin 24.7 – pas dorëzimit të kërkesës, atëherë kjo duhet të kuptohet si vendim për refuzimin e kërkesës.

24.4 Njësia për Regjistrimin e Pretendimeve të Agjencisë do t'i pranojë dhe regjistrojë këto kërkesa. Një Komision Shqyrtues menjëherë do të caktohet për shqyrtimin e kërkesës dhe do ta ushtrojë veprimtarinë në përputhje me nenin 66 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut Nr. 2003/13, me ndryshime.

24.5 Komisioni Shqyrtues duhet të marrë parasysh të gjitha provat dhe shkresat ekzistuese si dhe provat dhe shkresat e paraqitura më vonë nga pala e dëmtuara nga vendimi ose veprimi i Agjencisë ose komisionit të likuidimit.

24.6 Komisioni Shqyrtues do të vendosë mbi rastet në mënyrë të drejtë, të barabartë dhe të paanshme. Komisioni do të nxjerrë vendimet e tij së bashku me arsyetimet ligjore për ato vendime si dhe bazën faktike të vendimeve sa më shpejt që të jetë praktike, mirëpo asnjëherë më vonë se skadimi i periudhës gjashtëdhjetë ditore të përcaktuar në nenin 24.3, ose sipas rastit periudhës më të gjatë kohore të përcaktuar në nenin 24.7. Vendimi i Komisionit Shqyrtues përbën vendimin përfundimtar i cili nxirret nga Agjencia ose komisioni i likuidimit sipas nenit 66 (5) të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut Nr. 2003/13, me ndryshime.

24.7 Nëse, për shkaqe të cilat janë jashtë kontrollit të tij ose për shkak të kompleksitetit të një çështje të caktuar, Komisioni Shqyrtues nuk është në gjendje që të kryejë një shqyrtim të plotë brenda afatit kohor të përcaktuar në këto dispozita, Komisioni është i autorizuar që ta zgjasë afatin kohor për shqyrtimin e ankesës para skadimit të periudhës gjashtëdhjetë ditore, dhe për këtë duhet ta njoftojë palën ankuese. Asnjë zgjatje e këtillë nuk duhet të tejkalojë tridhjetë ditë. Nëse pala ankuese nuk është e kënaqur me vendimin për zgjatjen e afatit kohor për shqyrtimin e ankesës, ajo mund të aplikojë para Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës në përputhje me nenin 66 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut Nr. 2003/13 të datës 11 Qershor 2003, me ndryshime.

24.8 Secili vendim përfundimtar i Agjencisë, duke përfshirë komisionet e saj të likuidimit mund të kundërshtohet para Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës në përputhje me Ligjin në Fuqi.

Neni 25 **Auditimet e jashtme**

25.1 Do të ketë auditime vjetore të Agjencisë, duke përfshirë edhe auditime të jashtme financiare, në përputhje me procedurat standarde të veprimit të përcaktuara nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe auditime plotësuese për të cilat mund të vendosë Kuvendi i Kosovës.

25.2 Auditimet vjetore përveç Agjencisë do të shtrihen në çdo ndërmarrje dhe llogari besimi që administrohet drejtpërsëdrejti nga Agjencia. Fushëveprimi i çfarëdo auditimi plotësuese do të përcaktohet nga Kuvendi i Kosovës, varësisht nga rasti.

KREU VI

Zbatimi dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Neni 26 **Ndihma nga Qeveria e Kosovës**

Agjencia mund të kërkojë ndihmën e policisë dhe agjencive të tjera për zbatimin e ligjit të Qeverisë së Kosovës për zbatimin e kompetencave të saj sipas këtij ligji.

Neni 27 **Shqiptimi i gjobave**

27.1 Për zbatimin e kompetencave të saj sipas këtij ligji, Agjencia mund të shqiptojë gjobat e përcaktuara në këtë nen ndaj ndërmarrjeve, punonjësve dhe personave të tjerë me funksione menaxhuese ose mbikëqyrëse sa i përket ndërmarrjeve për:

- a) mosdhënien e përgjigjes brenda pesë ditësh pune nga dita e pranimit të kërkesës me shkrim nga një përfaqësues i autorizuar i Agjencisë për informatat ose dokumentacionin që është në posedim të të adresuarit, deri në njëqind euro (100 €) në ditë për çdo ditë të mos përgjigjes - deri në maksimumin prej pesë mijë eurosh (5.000 €);
- b) dhënien me qëllim të informatave të rrejtshme një përfaqësuesi të autorizuar të Agjencisë - deri në dhjetë mijë euro (10.000 €);
- c) shkatërrimin, falsifikimin, fabrikimin ose fshehjen e të dhënave mbi ndërmarrjen - deri në dhjetë mijë euro (10.000 €);
- d) fshehjen e qëllimshme ose transferimin e paligjshëm të aseteve të ndërmarrjes - deri në dhjetë mijë euro (10.000 €) ose në vlerën e aseteve të fshehura, cilado që është më e lartë; dhe

e) mosdorëzimin në Agjenci të çfarëdo aseti të ndërmarrjes pas marrjes së një urdhri me shkrim nga Bordi - deri në njëzet e pesë mijë euro (25.000 €) ose në vlerën e aseteve të pa dorëzuara, cilado që është më e lartë.

27.2 Të gjitha gjodat e shqiptuara konform nenit 27.1 duhet të nënshkruhen nga Drejtori Menaxhues ose një Zëvendës Drejtor Menaxhues dhe t'i dorëzohen ndërmarrjes ose personit në fjalë. Gjoda hyn në fuqi tridhjetë ditë (30) pas dorëzimit, përveç nëse pranuesi gjatë kësaj periudhe kohore paraqet ankesë para Komisionit Shqyrtues konform nenit 24.. Në këtë rast ekzekutimi i ndëshkimit do të pezullohet derisa gjoda të konfirmohet nga Komisioni Shqyrtues dhe ky konfirmim t'i dorëzohet ankuesit. Ankuesi mund ta kundërshtojë konfirmimin para Dhomës së Posaçme.. Dhoma e Posaçme mund të pezullojë zbatimin e ndëshkimit në pritje të vendimit përfundimtar.

Neni 28

Përgjegjësia për Dëmet

Çdo drejtor i ndërmarrjes dhe çdo person tjetër me funksion menaxhues dhe mbikëqyrës që ka lidhje me ndërmarrjen është përgjegjës për çfarëdo dëmi të shkaktuar ndërmarrjes si rezultat i mosrespektimit të udhëzimeve të ligjshme të përfaqësuesit të autorizuar të Agjencisë që vepron sipas autorizimeve të Agjencisë. Agjencia në emër të ndërmarrjes në fjalë ka autorizim të kërkojë pagimin e dëmit të tillë në gjykatën kompetente.

Neni 29

Të drejtat e Agjencisë në procedurat ligjore kundër ndërmarrjeve

29.1 Asnjë procedurë ligjore kundër një ndërmarrje nuk do të mbahet në gjykatë nëse kërkuesi nuk siguron dëshmi me shkrim se Agjencisë i është paraqitur njoftimi me shkrim lidhur me ngritjen e padisë në të cilën duhet të specifikohet emri i kërkuesit, emri i ndërmarrjes dhe të dhënat e tjera identifikuese, baza e ankesës dhe ndihma e kërkuar.

29.2 Agjencia ka të drejtë ligjore që të kërkojë çfarëdo të drejtash për një ndërmarrje në gjykatën kompetente në emër të asaj ndërmarrje.

29.3 Kurdo që procedurat ligjore janë në pritje të zgjidhjes së një çështje në emër të një ndërmarrje ose kundër saj, Agjencia në çdo kohë mund ta njoftojë gjykatën kompetente se ajo do të veprojë si përfaqësues ligjor i ndërmarrjes në fjalë, me kusht që ajo të veprojë si përfaqësues ligjor i vetëm një ndërmarrje në procedurën ku ka më shumë se një ndërmarrje.

Neni 30

Paditë gjyqësore kundër Agjencisë

30.1 Dhoma e Veçantë ka juridiksion ekskluziv për të gjitha paditë kundër Agjencisë.

30.2 Dhoma e Veçantë nuk do të pranojë asnjë padi kundër Agjencisë përveç nëse pala ankuese dorëzon dëshminë se e ka njoftuar kryesuesin e Bordit për dorëzimin e një padie të tillë së paku gjashtëdhjetë (60) ditë para dorëzimit të saj. Me kërkesën e Agjencisë Dhoma e

Veçantë mund të pezullojë hapjen e procedurës së padisë që është bërë kundër Agjencisë për një afat i cili nuk mund t'i kalojë gjashtëdhjetë (60) ditë nga dita e pranimin të padisë së tillë për të mundësuar një zgjidhje miqësore.

KREU VII

Dispozitat përfundimtare

Neni 31 Ligji në fuqi

31.1 Ky ligj mbisundon çdo dispozitë tjetër të ligjit në fuqi që është në kundërshtim me të.

31.2 Rregullorja e UNMIK-ut 2002/12, me ndryshimet dhe plotësimet e saj, nuk do të prodhojë efekte juridike pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

31.3 Agjencia merr përsipër të gjitha detyrimet të cilat ajo ose paraardhësja e saj i ka shkaktuar sipas Rregullores së UNMIK-ut 2002/12, me ndryshime dhe plotësime. Bordi dhe menaxhmenti i Agjencisë i përmbushin të gjitha përgjegjësitë e cilitdo Bordi ose menaxhmenti paraardhës të emëruar sipas Rregullores së UNMIK-ut 2002/12, me ndryshim plotësime.

Neni 32 Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 03/L-067
21 maj 2008**

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Jakup KRASNIQI